

Kërkesa për të hyra

Csaba Kovács
Zyra Hungareze për Energji

Trajnimi i NARUC/ERRA mbi Rregullimin e
Energjisë dhe Përpilimin e Tarifave

UNMIK/Kosovo
5-8 nëntor 2007

Parimet kryesore të rregullimit të tarifave

- **Çmimet nuk duhet rrezikuar rentabilitetin financiar të kompanive të rregulluara.** *Të gjitha kostot e justifikuara duhet të mbulohen, përfshirë edhe koston e aseteve kapitale.*
- **Rregullimi i çmimit duhet të stimulojë funksionimin më efikas.** *Duhet gjithashtu të merret si cak efikasiteti produktiv dhe alokativ – rregullimi i çmimeve stimuluese.*
- **Rregullimi i çmimeve duhet të jetë transparent dhe konsistent.** Thjeshtësia e strukturës mund të përcaktojë nivelin e besimit tek rregullimi.
- **Duhet shmangur intervenimet e shpeshta dhe të papritura.** Rregullatorët janë gjithmonë në situatë që përballen me informata joperfekte.

Përmbajtja e prezantimit

- Kalkulimi i të kërkesës për të hyra
 - Shpenzimet operative
 - Zhvlerësimi
 - Tatimet
 - Norma e fitimit
 - Baza e normës tarifore
- Këshilla dhe mesazhe praktike

Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Kërkesat për të hyra (RR) janë të ardhura (profit) dhe kosto njëkohësisht (firmat kundrejt konsumatorëve).

Kalkulimi i tyre zakonisht paraqet hapin e parë e të gjitha metodologjive të njohura të rregullimit të çmimit (metodologjia e normës së fitimit – gjithashtu të njohur si rregullimi i kostos-plus), apo kostoja e shërbimit, metoda e rregullimit të çmimeve stimuluese.

Ideja kryesore është që të ardhurat e kompanive të rregulluara të duhet të mbulojnë shpenzimet e tyre operative, taksat dhe amortizimin, dhe të duhet të sigurojnë një normë të duhur të fitimit (profitit) nga asetet e vëna në shërbim.

Hapi 1: Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Formula tipike për RR është si vijon:

$$RR = O + D + T + r * B$$

ku

RR = Kërkesa për të hyra

O = Shpenzime operative

D = Amortizimi

T = Tatimet


r = Norma e lejuar e fitimit

B = Baza e normës tarifore (apo baza e aseteve të rregulluara – RAB)

Për kalkulimin e RR, rregullatori duhet të mbledhë të gjitha elementet e formulës (kostot e detajuara dhe asetet e shqyrtuara).

Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Shembull: struktura e shpenzimeve (2006)



Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Shpenzimet operative (O) janë të ndërlidhura me operimin dhe mirëmbajtjen e centralit gjegjës dhe me ofrimin e shërbimeve të përgjithshme.

Mes artikujve kryesorë numërojmë:

- *Lëndën djegëse (gjenerimi)*
- *Energjinë e blerë (furnizimin me shumicë e pakicë)*
- *Mirëmbajtjen (gjenerim, transmision - distribucion)*
- *Koston e punonjësve (shpenzimet për punëtorë).*
- *Shërbimet*

Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Shpenzimet operative (O) janë të ndërlidhura me operimin dhe mirëmbajtjen e centralit gjegjës dhe me ofrimin e shërbimeve të përgjithshme.

- **O&M (Operacionet dhe Mirëmbajtja)** kosto të cilat mund të jenë të destinuara **drejtpërdrejt** për një funksion operativ.
- **A&G (Administrative dhe Gjenerale)** janë kostot që duhet të ndahen mes aktiviteteve operative – kosto të **tërthorta** (ngjashëm me koston që alokohet për shërbime të ndara dhe/apo kontraktuara nga jashtë).

Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Shpenzime speciale operative janë:

- **Humbjet në rrjet**

- Teknike – humbjet që ndërlidhen me transmisionin e elektricitetit.

- Joteknike (komerciale) – humbjet që paraqiten si pasojë e vjedhjes së energjisë elektrike dhe humbjet si pasojë e aksidenteve.

- **Llogaritë e painkasuara**(mospagimi nga konsumatorë jolikuidë) gjithashtu mund të merren parasysh si shpenzime operative (por kësisoj mospaguesit kurrë nuk do të çkyqen).


Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Shembull: Humbjet në rrjetin e distribucionit në

Hungari (%)

—◆— real (average) netw ork loss —■— justified netw ork loss

ZYRA HUNGAREZE PËR
ENERGJI



Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Zhvlerësimi (D, apo amortizimi) është shpenzim jo në të holla të gatshme që regjistrohet në deklarata financiare dhe i cili zvogëlon vlerën e aseteve të prekshme (paprekshme) si rezultat i vjetrimit dhe daljes nga përdorimi.

-Kostot e investimit që ndërlidhen me asete fikse nuk mund të zbriten nga të hyrat. Kjo alokohet përmes zhvlerësimit përgjatë jetëzgjatjes (kohës së shfrytëzimit) të asetit.

- Vlera vjetore varet nga politika e kompanisë mbi zhvlerësimin. Ekziston mundësia e zhvlerësimit në vijë të drejtë (linear) apo e zhvlerësimit të përsheptuar, dhe vlera e mbetur mund të merret në konsideratë.

Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Grupimi i mundshëm i metodave të zhvlerësimit

- Linear – Jolinear
- Normal – I jashtëzakonshëm
- Proporcional me kohën – I ndërlidhur me performansën.

Jeta e shërbimit: periudha kohore mes instalimit të njësisë dhe pensionimit të së njëjtës, që shfrytëzohet për qëllime kontabilare.

Vlera neto e mbetur: Vlera e mbetur minus kostot që janë paraqitur me pensionim.

Vlera e shërbimit: kostoja origjinale minus vlera neto e mbetur që parashikohet.

Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Shembull: Kohëzgjatje të dobishmërisë për kalkulimin e zhvlerësimit

Grupi i asetëve	Kohëzgjatja e nxjerrjes së dobisë nga aseti i ri (vite)
Linjat HVL (120 kV)	35
Linjat MVL (10-35 kV)	30
Linjat LVL	25
Transformuesit	25-30
Ndërtesat	50
Veturat	8

Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Tatimet (T) mund të jenë të bazuara në të hyra dhe jo të bazuara në të hyra (p.sh tatimi mbi vlerën e shtuar).

Në rast të kalkulimit të shpenzimeve për tatim të korporatës ju duhet ta harmonizoni atë me normën e aplikueshme të fitimit!

Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Norma e fitimit (r) është rendimenti i pritur i kompanisë (industrialisë), duke marrë parasysh koston e financimit të biznesit (koston e kapitalit)

Kostoja e kapitalit të huazuar (borxh): shpenzimet për kamata.

Kostoja e kapitalit: fitimet apo investimet tjera të mundshme që bartin rreziqe të ngjashme (kostoja e mundësisë)

Dhënësit e huasë kërkojnë normë fikse kamatore për investimet e tyre.

Pronarët e kapitalit janë ‘kërkues konstantë’ të të hyrave – të mbetjes pasi që të gjitha obligimet e pagesës tu jenë alokuar atyre.

Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Kostoja e kapitalit zakonisht matet si **Kosto Mesatare e Matur e Kapitalit**. Paraqet proporcion të kapitalit të shumëzuar me koston e kapitalit, plus proporcioni i borxhit shumëzuar me koston pas tatimit të borxhit.

$$WACC = re^*(E/(E+D))+rd^*(1-tc)^*(D/(E+D))$$

Ku

re = norma e kërkuar e fitimit nga kapitali

rd = norma e fitimit nga huazimet

E = kapitali

D = borxhi

tc = norma e tatimit për korporata

Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Shembull: WACC Hungarez (Viti 2005, Tarifat e rrjetit të distribucionit)

$$WACC = re * (E / (E + D)) + rd * (1 - tc) * (D / (E + D))$$

$$WACC \text{ Para Tatimit} = (8,3 \% * 0,5) + (5,8 \% * 0,5) = 7,1 \%$$

Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Kostoja e kapitalit (r_e) zakonisht tentohet të përcaktohet përmes **Modeli i Përcaktimit të Çmimeve për Asete Kapitale (CAPM)**.

$$r_e = r_f + \beta_e * (r_m - r_f)$$

Ku

r_e = norma e kërkuar e fitimit nga kapitali

r_f = norma e fitimit pa rrezik (p.sh. llogaria mbi thesarin)

β_e = Beta, ndryshueshmëria relative e një stoku të caktuar në treg

r_m = rreziku i tregut


Shembulli Hungarez (2005, Tarifat e rrjetit të distribucionit)

r_e pas tatimit = $5,3 + 0,4 * 4,3 = 7 \%$

r_e para tatimit = $7 / (1 - 0,16) = 8,3 \%$

Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Modeli i Përcaktimit të Çmimeve për Asete Kapitale (CAPM)



Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Baza e Aseteve të Rregulluara (Baza e normës, B) paraqet vlerën e investimeve nga të cilat kompania mund të fitojë një normë të arsyeshme të fitimit.


Metoda kryesore për vlerësimin e asetit është: kostoja origjinale minus zhvlerësimi i akumuluar vjetor.

Pika fillestare është vlera bruto e asetëve fikse në relacion me aktivitetin e rregulluar. Me zbritjen e zhvlerësimit të akumuluar të asetëve arrijmë tek neto vlera kontabilare e asetëve fikse.

Kapitali punues (asetet aktuale – obligimet aktuale) gjithashtu mund të jetë pjesë e Bazës së Normës.

Kalkulimi i kërkesës për të hyra

Shembull: Kërkesa për të hyra në distribucion
(Hungari, 2007, %)



■ Depreciation ■ Cost of capital ■ Operating expenses ■ Justified network loss

Këshilla dhe mesazhe praktike (1)

- Gjatë kalkulimit të kërkesës për të hyra, përveç analizimit të vlerave të kaluara të shpenzimeve operative, duhet të bëhen edhe përshtatje për të ardhmen e parashikueshme.
- Llogaritja, tatimimi dhe kërkesat e zhvlerësimit rregullativ zakonisht devijojnë nga njëra tjetra.
- Asetet të cilat nuk janë financuar nga vetë kompania (por nga subvencionet apo kontributet e konsumatorëve) nuk mund të jenë pjesë të bazës së aseteve të rregulluara.
- Ju nuk duhet të shfrytëzoni strukturën e kapitalit real gjatë kalkulimit të WACC. Gjithashtu është i mundshëm shfrytëzimi i borxheve dhe kapitalit virtual (megjithëse kjo është kontestuese).

Këshilla dhe mesazhe praktike (2)

- Në raste të aseteve të vjetra, vlera kontabilare neto është shumë më e ulët se sa vlera zëvendësuese e zhvlerësuar (kryesisht në raste kur norma e inflacionit është mjaft e lartë).
- Bilancet e gjendjes së mesit të vitit apo ato 12 mujore mund të shfrytëzohen si bazë e mirëfilltë për përcaktimin e tarifave.
- Ndërtimet në progres (investime të pafinalizuara) gjithashtu mund të jenë pjesë e bazës së normës, por zakonisht rregullatorët nuk preferojnë financimin përmes tarifave para operimit.

Ju falemderit për vëmendje!

Csaba Kovács

kovacscs@eh.gov.hu

+36-1-459-7747